



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Në bazë të nenit 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6 të Rregullores Nr. 13/2026 për Emërimin dhe Përfundimin e Mandatit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, si dhe në mbështetje të vendimit Nr.01/882/2026 datë 28.08.2026, të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, Akademia e Drejtësisë me datën 01.09.2026, shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës:	Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë
Klasa e pozitës:	Drejtues i Lartë
Nr. i kërkuar:	1 (një)
Institucioni:	Akademia e Drejtësisë
Vendi i punës:	Prishtinë
Numri i referencës:	01/2026/ZD-AD
Kohëzgjatja e emërimit:	Me mandat katër (4) vjeçar
Afati për aplikim:	02.09.2026 – 01.10.2026

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Përfaqëson Akademinë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- Është përgjegjës për menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë së Drejtësisë;
- Merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote dhe kryeson Këshillin Programor;
- Siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- Propozon projektbugetin vjetor të Akademisë së Drejtësisë;
- Propozon programin e punës së Akademisë së Drejtësisë;
- Propozon Strategjinë, Planin e Punës dhe Programin e trajnimeve;
- Propozon listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista cakton trajnuesit për zbatim të programit;
- Menaxhon me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë së Drejtësisë;
- Propozon Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Akademisë së Drejtësisë, Projekt Rregulloren mbi përzgjedhjen e trajnuesve, Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues dhe Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Programor dhe akte tjera nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.
- Përgatit raporte të rregullta vjetore dhe raporte të tjera sipas kërkesës së Këshillit Drejtues;
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Akademisë së Drejtësisë.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin përkatës për Gjuhët;
- Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e vepër penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë kaluar me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me këtë Rregullore;
- Të jetë jurist i diplomuar dhe të ketë provimin e jurisprudencës;
- Të ketë tetë (8) vjet përvojë profesionale, prej të cilave pesë (5) vjet përvojë menaxhuese.

Të tjera:

- Njohja e gjuhës angleze e preferuar

Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit:

- Aftësi të larta organizative, drejtuese (leadership) të hartimit të politikave dhe menaxhimit strategjik.
- Shkathtësi të shkëlqyera strategjike dhe analitike që i mundësojnë të këshilloj për çështje komplekse, me besueshmëri dhe vendosmëri në arritjen e objektivave strategjike të institucionit.
- Aftësi për të udhëhequr, bashkëpunuar dhe për të menaxhuar ndryshime të rëndësishme në organizata të mëdha dhe komplekse.
- Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së institucionit, menaxhimit buxhetor dhe të shërbimit civil.
- Aftësi për t'iu përshtatur ndryshimeve të prioriteteve, kërkesave dhe afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi të forta negociimi, komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me titullarin e institucionit dhe stafin që menaxhon.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs dhe, nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin;
- Kopje e certifikatës për provimin e dhënë të Jurisprudencës;
- Kopje të dëshmimeve të punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklарohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së

përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës. Dëshmia e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet me së paku njërën nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;

- Kopjet e dokumenteve tjera që vërtetojnë plotësimin e kushteve të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Verifikimi paraprak;
- Vlerësimi profesional (testim me shkrim dhe intervistë).

Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Përmes ueb faqes së institucionit dhe në mënyrë elektronike (email).

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP;

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Akademisë së Drejtësisë, duke filluar nga data 02.09.2026 gjer më 01.10.2026 si datë e mbylljes së konkursit.

Mënyra e dorëzimit:

Aplikacioni së bashku me dokumentet mbështetëse mund të dorëzohet në Akademinë e Drejtësisë në formë fizike, përmes postës ose postës elektronike, i cili regjistrohet dhe secili kandidat pajiset me një konfirmim mbi pranimin e aplikacionit.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 në Akademinë e Drejtësisë, rruga “Murat Mehmeti” nr.1-3, te Zyrtarja e lartë për Burime Njerëzore, kati

përdhesë, zyra nr.002, 10000 Prishtinë, Kosovë, si dhe përmes postës elektronike: burimenjerezore.ad@rks-gov.net.

Aplikimi përmes postës: Aplikacionet e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në adresën: Akademia e Drejtësisë, rr. "Murat Mehmeti" nr.1-3, 10000 Prishtinë, Kosovë. te Zyrtarja e lartë për Burime Njerëzore, kati përdhesë, zyra nr.002.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 5 pesë ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata plotësuese mund të kontaktoni në këtë numër telefoni: 038 200 68 011, prej orës 08:00-16:00, ose në emailin: burimenjerezore.ad@rks-gov.net.